

PËRSHKRIMI I VLERËS INVESTIVE

**PËR PROJEKTIN ME TITULL: FABRIKË PËR RICIKLIM TË PLASTIKËS PVC
ZONA KADASTRALE DUSHANOVË KOMUNA PRIZREN
PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR KOMPANIA
Skender Hoxhaj B.I.
"Sem-Pro" N.T.P**

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
Shuma totali investive:		

Aplikuesi i projektit:

z. Skender Hoxhaj, **drejtor**

_____ **v.v.**

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës			
Data e aplikimit			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	FABRIKË PËR RICIKLIM TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS PVC		
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	€		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,	Po	Jo	
1. Raporti i VNM-së në një (1) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-së (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).	X		
2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore	X		
3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit	X		
4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).	X		
5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref	X		
6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar	X		
7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor			
8. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;	X		
9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit	X		
10. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive: Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve			
11. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.	X		
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	z. Skender Hoxhaj		
Kompania	Skender Hoxhaj B.I. "Sem-Pro" NTP		
Adresa e Kompanisë	Dushanovë – Prizren		
Tel, fax, E-maili	Tel.: +383 44 243 162 E-mail: semproks@yahoo.com		

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR FABRIKËN PËR RICIKLIM TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS PVC**



Për : Skender Hoxhaj B.I. dhe emër tregtar “Sem-Pro” N.T.P
Titulli i Projektit : FABRIKË PËR RICIKLIM TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS PVC
Ngastra kadastrale :P-71813023-00035-10
Vendi i quajtur : Barutni-Magacin - Puta
Zona Kadastrale : Dushanovë
Komuna : Prizrenit
Aplikuesi i Projektit : Skender Hoxhaj

Mars 2026

Aplikuesi:

Kompania: **"Skender Hoxhaj" B.I.**

"Sem-Pro" NTP

Drejtor z. Skender Hoxhaj

Adresa: Turgut Ozal p.n. Prizren

Tel.: +383 44 243 162

E-mail: semproks@yahoo.com

Hartuesi i raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi - Kastrati

Eksperte e licencuar për VNM

Nr. Licencës së lëshuar nga MMPHI:

70/17

Adresa:

Rr. Holger Petersen p.n.

Lagja Prishtina e Re

Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: edonak88@gmail.com

Kompania: Skender Hoxhaj B.I. "Sem-Pro" NTP

z. Skender Hoxhaj, drejtor

_____ v.v.

Hartuese e Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

Përmbajtja:

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	8
1.1. Të dhënat për aplikuesin	8
1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së.....	8
1.3. Të dhënat kryesore për projektin.....	8
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	9
2.1. Kategoria e projektit të propozuar.....	9
Rregullativa Ligjore	9
2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	10
2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	11
2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të riciklimit dhe prodhimit.....	11
2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme.....	13
2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik	14
2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave	15
2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit.....	16
2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme.....	17
2.10. Aktivitetet shtesë për zbatimin e projektit	19
2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme	19
2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera	19
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....	20
3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti.....	20
3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit	20
3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth	23
3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike.....	24
3.5. Burimi i furnizimit me ujë	25
3.6. Karakteristikat klimatike	25
3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna).....	26
3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale	26
3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike.....	27
3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike	27
3.11. Objektet ekzistuese	28
3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta	28
4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT.....	28
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	31
5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme.....	31
5.2. Arsye kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar	32
5.3. Vendndodhja ose rruga	33
5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....	34
5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit.....	35

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit	36
5.7. Plani i lokacionit.....	37
5.8. Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit	38
5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	38
5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit	38
5.11. Vëllimi i prodhimit	39
5.12. Kontrolli i ndotjes.....	39
5.13. Trajtimi i mbeturinave	40
5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes	40
5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit	40
5.16. Trajnime	40
5.17. Monitorimi	40
5.18. Planet për situata emergjente.....	40
5.19. Demolimi dhe rehabilitimi	41
5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit	41
5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim	41
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS.....	42
6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis	42
6.2. Cilësia e ajrit	42
6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër	42
6.4. Ndikimi i projektit në klimë.....	43
6.5. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit	43
6.6. Cilësia e ujit	43
6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	44
6.8. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	45
6.9. Ndryshimet hidromorfologjike	45
6.10. Toka.....	45
6.11. Ndikimi fizik dhe topografia	45
6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokë	46
6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore	46
6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur.....	46
6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike.....	46
6.16. Ndikimi në popullsinë locale.....	47
6.17. Ndikimi në shëndetin e popullsisë	47
6.18. Rreziku nga aksidentet dhe situatat emergjente.....	47
6.19 - 23. Ndikimi psikologjik dhe social	47
6.24. Ndikimi në ekosistemet lokale	47
6.25. Ruajtja e biodiversitetit	48
6.26. Ndikimi në strukturën gjeologjike dhe gjeomorfologjike	48

6.27–6.29. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve	48
6.30–6.33. Infrastruktura komunale	48
6.34–6.35. Ujërat e zeza dhe gjenerimi i mbeturinave	48
6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore dhe kulturore	48
6.37–6.44. Ndikimet nga implementimi dhe aksidentet.....	49
7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS	49
7.1. Masat e parashikuara me legjislacion	49
7.1.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	49
7.1.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	49
7.1.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	50
7.1.4. Masat për mbrojtje nga zhurma	50
7.1.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peisazh, florë dhe faunë.....	50
7.1.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	51
7.1.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	52
7.1.7. Menaxhimi i mbeturinave.....	52
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	53
8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	53
8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të aktiviteteve të projektit	53
8.3. Parametrat për përcaktimin e efektit të dëmshëm.....	53
8.4. Vendndodhjet, mënyra dhe shpeshtësia e matjeve	54
8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve.....	55
8.6. Detyrimi për të informuar publikun	55
8.7. Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis (sipas rastit).....	55
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....	55
9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit.....	55
9.2. Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor	56
9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me ISO 14000	56
10. KONKLUZIONE.....	57
11. BURIMET E TË DHËNAVE - LITERATURA.....	58
12. SHTOJCA.....	58

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1. Të dhënat për aplikuesin

Aplikues i projektit është kompania Skender Hoxhaj B.I. me emrin tregtar “Sem-Pro” NTP, e cila ka selinë në Dushanovë komuna e Prizrenit. Përfaqësues i autorizuar i kompanisë dhe aplikues i projektit është z. Skender Hoxhaj i cila mban poziten e drejtorit.

1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar nga Dr.sc. Edona Kabashi–Kastrati, eksperte e licencuar për VNM me Nr. Licencës 70/17, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH). Raporti është hartuar duke përdorur burime të ndryshme të dhënash dhe duke ndjekur procedurat profesionale të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

1.3. Të dhënat kryesore për projektin

Ky Raport i VNM-së është përgatitur në kuadër të procedurës për pajisjen me Pëlqim Mjedisor për vazhdimin e aktivitetit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC nga kompania “Sem-Pro” NTP.

Aktiviteti i propozuar do të zhvillohet në lokacionin e njohur si “Barutni-Magacin - Puta”, në parcelën me numër P-71813023-00035-10, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për VNM, ky raport ka për qëllim:

- identifikimin dhe analizimin e burimeve potenciale të ndotjes;
- vlerësimin e ndikimeve të mundshme në komponentët e mjedisit (ajri, uji, toka, biodiversiteti dhe shëndeti i popullatës);
- përcaktimin e masave parandaluese, zbutëse dhe kontrolluese për menaxhimin e ndikimeve brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Vlerësimi i ndikimeve është bazuar në dokumentacionin teknik të projektit, karakteristikat fiziko-gjeografike të lokacionit, si dhe në gjendjen ekzistuese të mjedisit në zonën përreth.

Në mënyrë të veçantë, raporti trajton ndikimet që lidhen me:

- menaxhimin e mbetjeve të gjeneruara gjatë procesit të riciklimit;
- emetimet në ajër (përfshirë pluhurin);
- nivelet e zhurmës gjatë operimit të pajisjeve teknologjike.

Qëllimi kryesor është sigurimi i një niveli të pranueshëm të mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kërkesat ligjore në fuqi.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Projekti i propozuar bën pjesë në kategorinë e aktiviteteve industriale për menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve, përkatësisht në fushën e riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ky aktivitet klasifikohet si projekt që i nënshtrohet procedurës së VNM-së, për shkak të natyrës së tij dhe potencialit për të gjeneruar ndikime në komponentët e mjedisit, veçanërisht në ajër, ujë dhe tokë. Aktiviteti përfshin grumbullimin, selektimin, përpunimin mekanik dhe riciklimin e mbeturinave të plastikës PVC, me qëllim ripërdorimin e tyre si lëndë e parë sekondare në procese të mëtejshme prodhuese.

Duke marrë parasysh karakterin e aktivitetit, projektit i atribuohen ndikime të mundshme mjedisore, të cilat kërkojnë vlerësim të detajuar dhe zbatim të masave adekuate për parandalimin dhe minimizimin e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.

Rregullativa Ligjore

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë “Sem-Pro” NTP e cila planifikon të zhvillojë aktivitetin e riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat

- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi administrative (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajer nga burimet e palevizshme te ndotjes.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 për katalogun Shtetëror të mbeturinave.

2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Objekti për riciklimin e mbeturinave të plastikës PVC në lokacionin “Barutni-Magacin - Puta” është i përfunduar dhe funksionon aktualisht. Aktiviteti përfshin grumbullimin, selektimin, përpunimin mekanik dhe riciklimin e mbetjeve të PVC, sipas procedurave standarde operative dhe në përputhje me kërkesat mjedisore.

Infrastruktura e vendosur përfshin:

- Magazina të përshtatura për ruajtjen e mbetjeve të riciklueshme;
- Pajisje për përpunim mekanik dhe riciklim të mbetjeve PVC;
- Sisteme për kontrollin e pluhurit dhe reduktimin e zhurmës;
- Sisteme të menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta dytësore.

Aktiviteti operohet me procedura të standardizuara për sigurinë industriale dhe mbrojtjen e mjedisit, përfshirë monitorimin e emetimeve, menaxhimin e mbetjeve dhe trajnimet e stafit. Gjendja aktuale e objektit siguron që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe komunitet.

2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Aktiviteti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC nga kompania "Sem-Pro" NTP zhvillohet në lokacionin "Barutni-Magacin - Puta" dhe përfshin të gjitha fazat e përpunimit të mbetjeve të PVC nga pranimi deri te riciklimi final. Karakteristikat kryesore të funksionimit janë si më poshtë:

1. Pranimi dhe magazinimi i mbetjeve:

- Mbetjet e PVC pranohet nga furnitorë të autorizuar dhe depozitohen në magazina të dedikuara, të cilat ofrojnë mbrojtje nga lagështia dhe ndotja e jashtme.

2. Selektimi dhe përpunimi mekanik:

- Mbetjet selektohen sipas tipit dhe pastrohen nga papastërtitë;
- Përpunimi mekanik përfshin thyerjen, grimcimin dhe përgatitjen e materialit për riciklim.

3. Riciklimi dhe prodhimi i lëndës së parë sekondare:

- Materiali i përpunuar shndërrohet në lëndë të parë sekondare, e cila përdoret për prodhimin e dërrasave dhe profileve të plastikës;
- Ky proces realizohet duke respektuar parametrat teknikë dhe ambientalë, me qëllim minimizimin e humbjeve dhe mbetjeve dytësore.

4. Menaxhimi i mbetjeve dhe emetimeve:

- Të gjitha mbetjet që nuk mund të riciklohen trajtohen sipas procedurave ligjore dhe standardeve mjedisore;
- Sistemet e filtrimit dhe ventilimit reduktojnë pluhurin dhe gazrat e mundshëm;

5. Organizimi dhe siguria e punës:

- Aktiviteti funksionon nën procedura të standardizuara për sigurinë industriale dhe mbrojtjen e punonjësve;
- Trajnimi i stafit mbi masat mjedisore dhe operationale është i detyrueshëm dhe periodik.

2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të riciklimit dhe prodhimit

Procesi fillon me pranimin dhe kontrollin e materialit të ricikluar. Mbetjet e PVC-së vijnë nga furnitorë të autorizuar dhe kontrollohen për llojin e plastikës, ngjyrën dhe nivelin e ndotjes. Materialet që nuk plotësojnë standardet për riciklim veçohen dhe dërgohen për trajtim të veçantë ose për menaxhim të mbetjeve.

Pasi materiali miratohet, ai depozitohet në magazina të përshtatura, të cilat ofrojnë mbrojtje nga lagështia, dielli dhe ndotjet e jashtme. Më pas, materiali i ricikluar selektuar sipas ngjyrës, përbërjes dhe madhësisë, pastrohet nga papastërtitë e dukshme dhe objektet jo të dëshirueshme. Ky hap siguron që produkti final të ketë cilësi të qëndrueshme dhe homogjene.

Hapi i tretë është përpunimi mekanik, i cili përfshin: Thyerjen dhe grimcimin e materialit në madhësi të përshtatshme për procesin e riciklimit; Homogjenizimin e materialit për të siguruar uniformitet në përbërje; Kontrollin e cilësisë së materialit të përpunuar për parametrat e lagështisë, densitetit dhe madhësisë së grimcave.


Hapi i katërt është ekstruzimi dhe formimi i produkteve, ku materialet e përpunuara futen në makineritë e ekstruzimit. Materiali nxehet në temperatura të kontrolluara për shkrirjen e tij, dhe më pas formohet në: Dërrasa plastike me dimensione të caktuara; Profile plastike sipas formave të parapara (profil linear, kanale, bordura, etj.).

Gjatë ekstruzimit monitorohen me kujdes parametrat teknikë: temperatura e shkrirjes, presioni i materialit, shpejtësia e ekstruzionit dhe koha e ftohjes, për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve.

Hapi i pestë përfshin ftohjen, prerjen dhe paketimin: Produktet e formuara kalojnë në tunelet e ftohjes për të stabilizuar strukturën e plastikës; Pasi ftohen, ato prerën sipas dimensioneve të kërkuara për tregun ose klientët industrialë; Në fund, produktet pakohet dhe etiketohen për ruajtje, transport dhe distribuim, duke siguruar mbrojtje nga dëmtimet.

Menaxhimi i mbetjeve dhe kontrolli ambiental është një pjesë integrale e procesit: Mbetjet që nuk mund të përdoren trajtohen sipas procedurave të standardizuara mjedisore; Sistem ventilimi dhe filtrimi zvogëlon emetimin e pluhurit dhe gazrave të mundshëm në ambient; Monitorohet vazhdimisht niveli i zhurmës, emetimet dhe parametrat ambientale sipas kërkesave të MMPH dhe standardeve ISO të mjedisit.

Siguria dhe organizimi i punës: Procedurat e sigurisë industriale dhe masat për mbrojtjen e punonjësve duhet të janë të integruara në çdo fazë; Trajnimet periodike për stafin duhet të mbulojnë procedurat operative, masat mjedisore dhe protokollet e emergjencës; Planet e emergjencës dhe protokollet për incidentet mjedisore duhet të janë të implementuara dhe të testuara rregullisht.



2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme

Për funksionimin e aktivitetit të riciklimit të mbeturinave të PVC dhe prodhimin e dërrasave dhe profileve plastike, nevojiten burime të ndryshme materiale, energjetike dhe njerëzore, si më poshtë:

1. Materiale të ricikluara:

- Mbetje plastike PVC;
- Materiale ndihmëse për përpunim, si aditivë për stabilizim, ngjyra dhe lubrifikantë: sasia përcaktohet sipas llojit të produktit të prodhuar;
- Materiale për paketim të produkteve: kuti, shiritë mbrojtës, etiketa.

2. Energjia dhe lëndët djegëse:

- Energjia elektrike: përdoret për makineritë e përpunimit, ekstruzimin, sistemet e ventilimit dhe ftohjes;
- Gaz dhe lëndë djegëse të tjera (nëse përdoren në ekstruzimin ose ngrohjen e materialit): sasia përcaktohet sipas parametrave teknikë të makinerive.

3. Uji dhe burimet e tjera të natyrës:

- Uji i përdorur për ftohje dhe pastrim të pajisjeve;
- Materiale për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbetjeve: kimikate të lejuara dhe filtrues sipas standardeve mjedisore.

4. Burimet njerëzore:

- Personeli operativ: teknikienë dhe punonjës për përpunimin dhe riciklimin e materialit;
- Personeli mbështetës: menaxherë, inxhinierë, staf i sigurisë industriale dhe ambiental;

- Trajnime periodike për procedurat operative, masat mjedisore dhe sigurinë e punës.

5. Burimet teknike dhe pajisjet:

- Makineri për thyerje, grimcim dhe selektim të materialit;
- Linja ekstruzimi për prodhimin e dërrasave dhe profileve plastike;
- Sisteme ftohjeje, ventilimi dhe filtrimi;
- Pajisje monitorimi të nivelit të zhurmës, emetimeve dhe parametrave të tjerë ambientale.

Të gjitha burimet e përdorura duhet të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, sipas planeve të menaxhimit të burimeve dhe standardeve ligjore mjedisore. Sasia dhe përdorimi i tyre përcaktohet për të siguruar funksionim të vazhdueshëm, efikas dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet industriale.

2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë procesit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimit të dërrasave dhe profileve plastike, gjenerohen lloje të ndryshme mbetjesh dhe emisionesh, të cilat menaxhohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.

Mbetjet e ngurta

Gjatë fazave të selektimit, përpunimit dhe prodhimit gjenerohen mbetje të ngurta, të cilat përfshijnë:

- Materiale plastike të papërshtatshme për riciklim (PVC i ndotur ose i përzier me materiale të tjera);
- Papastërti të ndara gjatë procesit të selektimit (metal, letër, mbetje të tjera);
- Mbetje dytësore nga procesi i prodhimit (copëza, mbetje prerjeje, produkte jashtë standardit).

Një pjesë e këtyre mbetjeve riqarkullohet në procesin e prodhimit, ndërsa pjesa tjetër trajtohet dhe dërgohet te operatorë të licencuar për menaxhimin e mbetjeve.

Ujërat e ndotura

Ujërat e përdorura gjenerohen kryesisht nga:

- Pastrimi i materialit të ricikluar;
- Ftohja e produkteve dhe pajisjeve teknologjike.

Këto ujëra mund të përmbajnë grimca plastike dhe ndotës të tjerë dhe trajtohen përmes sistemeve adekuate para shkarkimit, në përputhje me standardet për ujërat e ndotura.

Emetimet në ajër

Gjatë operimit të pajisjeve dhe proceseve të përpunimit mund të gjenerohen:

- Pluhur nga procesi i thyerjes dhe grimcimit të materialit;
- Avuj dhe gaze të lehta gjatë procesit të ngrohjes dhe ekstruzimit të PVC-së;

Për reduktimin e këtyre emetimeve duhet të përdoren sisteme ventilimi dhe filtrimi, duke siguruar që nivelet e ndotjes të mbeten brenda kufijve të lejuar.

Zhurma dhe vibrimet

Burimet kryesore të zhurmës janë makineritë për përpunim mekanik dhe linjat e ekstruzimit. Niveli i zhurmës duhet të monitorohet dhe kontrollohet përmes:

- Vendosjes së pajisjeve në ambiente të mbyllura;
- Mirëmbajtjes së rregullt të makinerive;
- Përdorimit të masave mbrojtëse për punonjësit.

Emetimet e tjera

Në kuadër të aktivitetit mund të gjenerohen edhe:

- Emetime indirekte nga konsumi i energjisë elektrike;
- Mbetje të rrezikshme në sasi të vogla (vajra teknikë, filtra të përdorur), të cilat menaxhohen sipas rregullave për mbetje të rrezikshme.

2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave

Në kuadër të aktivitetit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe profileve plastike, zbatohen teknologji të përshtatshme për trajtimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve, me qëllim minimizimin e ndikimeve në mjedis dhe sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të tyre.

Trajtimi dhe përpunimi i mbetjeve të riciklueshme

Mbetjet plastike të PVC-së që plotësojnë kriteret teknike i nënshtrohen procesit të riciklimit, i cili përfshin:

- Selektimin dhe ndarjen sipas llojit dhe cilësisë së materialit;
- Pastrimin nga papastërtitë dhe përbërësit e padëshiruar;
- Përpunimin mekanik (thyerje, grimcim dhe homogjenizim);
- Ri-përdorimin e materialit të përpunuar në procesin e ekstruzimit për prodhimin e dërrasave dhe profileve plastike.

Kjo teknologji mundëson reduktimin e sasisë së mbetjeve që kërkojnë trajtim përfundimtar dhe kontribuon në përdorimin efikas të burimeve.

Trajtimi i mbetjeve të pa riciklueshme

Mbetjet që nuk janë të përshtatshme për riciklim (p.sh. materiale të përziera ose të kontaminuara) ndahen dhe depozitohen përkohësisht në zona të dedikuara brenda lokacionit, në kushte të kontrolluara. Këto mbetje më pas:

- Dërgohen për trajtim ose asgjësim te operatorë të licencuar për menaxhimin e mbetjeve;
- Trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit.

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme

Në kuadër të aktivitetit mund të gjenerohen sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, si: vajra teknikë të përdorur, filtra dhe materiale të kontaminuara. Këto mbetje:

- Identifikohen dhe klasifikohen sipas legjislacionit për mbetjet e rrezikshme;
- Ruhen në enë të mbyllura dhe të etiketuara në zona të veçanta;
- Dorëzohen te operatorë të licencuar për trajtim dhe asgjësim të sigurt.

Trajtimi i ujërave të ndotura

Ujërat e gjeneruara gjatë procesit (pastrimi dhe ftohja) trajtohen përmes sistemeve të përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë:

- Sedimentimin e grimcave të ngurta;
- Filtrimin dhe, nëse është e nevojshme, trajtime shtesë për përmirësimin e cilësisë së ujit;

Pas trajtimit, ujërat shkarkohen në përputhje me standardet dhe kufijtë e lejuar ligjorë.

Masat për minimizimin e mbetjeve

Për të reduktuar gjenerimin e mbetjeve dhe ndikimet mjedisore, zbatohen këto masa:

- Riqarkullimi i mbetjeve plastike brenda procesit prodhues;
- Optimizimi i proceseve teknologjike për të minimizuar humbjet;
- Monitorimi i vazhdueshëm i proceseve dhe mirëmbajtja e pajisjeve;
- Zbatimi i praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit

Programi i projektit përfshin tri faza kryesore: ndërtimin, funksionimin dhe rehabilitimin e lokacionit, të cilat janë të planifikuara dhe zbatohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.

Faza e ndërtimit - Faza e ndërtimit të objektit për riciklimin e mbeturinave të plastikës PVC është përfunduar. Gjatë kësaj faze janë realizuar punimet ndërtimore dhe instalimi i infrastrukturës teknologjike, përfshirë:

- Ndërtimin dhe përshtatjen e objekteve për prodhim dhe magazinim;
- Vendosjen e linjave të përpunimit dhe pajisjeve teknologjike;
- Instalimin e sistemeve ndihmëse (energji elektrike, ventilim, ftohje dhe menaxhim i ujërave).

Punimet janë realizuar duke respektuar kërkesat teknike dhe masat për mbrojtjen e mjedisit.

Faza e funksionimit (operimit) - Aktiviteti i riciklimit dhe prodhimit është aktualisht në funksion dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, sipas kapaciteteve teknike dhe kërkesave të tregut.

Gjatë kësaj faze:

- Kryhen proceset e pranimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të PVC-së;
- Prodhimi i dërrasave dhe profileve plastike realizohet në linja të specializuara;
- Zbatohen masa për menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e emetimeve dhe reduktimin e zhurmës;
- Realizohet monitorimi i rregullt i parametrave mjedisorë dhe mirëmbajtja e pajisjeve.

Kjo fazë përfaqëson periudhën më të gjatë të projektit dhe ka rëndësi të veçantë për menaxhimin e ndikimeve në mjedis.

Faza e rehabilitimit (pas përfundimit të aktivitetit) - Pas ndërprerjes së aktivitetit, do të ndërmerren masa për rehabilitimin e lokacionit, me qëllim rikthimin e tij në një gjendje të përshtatshme mjedisore. Këto masa përfshijnë:

- Largimin e pajisjeve dhe instalimeve teknologjike;
- Pastrimin e plotë të lokacionit nga mbetjet dhe materialet e mbetura;
- Trajtimin e mundshëm të ndotjeve në tokë dhe ujë, nëse identifikohen;
- Rikultivimin dhe rikthimin e sipërfaqes së tokës në gjendje të përshtatshme për përdorim të mëtejshëm.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për funksionimin e aktivitetit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimin e dërrasave dhe profileve plastike, është siguruar infrastruktura e nevojshme teknike dhe mbështetëse, e cila mundëson operim të sigurt, efikas dhe në përputhje me standardet mjedisore.

Infrastruktura ndërtimore dhe hapësinore

- Objekti prodhues është i ndërtuar dhe i përshtatur për proceset e riciklimit dhe prodhimit;

- Ka hapësira të dedikuara për magazinimin e lëndës së parë (mbetje PVC) dhe produkteve finale;
- Ka zona të veçanta për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve;
- Janë rregulluar rrugë të brendshme për qarkullimin e mjeteve dhe manipulimin e materialeve.

Furnizimi me energji

- Objekti është i kyqur në rrjetin e energjisë elektrike për furnizimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike;
- Janë instaluar sisteme shpërndarëse dhe mbrojtëse për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji;
- Aplikohen burime alternative për furnizim me energji.

Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i ujërave

- Furnizim me ujë për nevoja teknologjike (ftohje, pastrim) dhe sanitare;
- Nuk ka sisteme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura;
- Ka kanalizim të kontrolluar në përputhje me standardet mjedisore.

Sistemet teknologjike dhe ndihmëse

- Linja teknologjike për përpunimin dhe riciklimin e PVC-së;
- Pajisje për ekstruzim dhe formim të dërrasave dhe profileve plastike;
- Sisteme ventilimi dhe filtrimi për reduktimin e pluhurit dhe emetimeve;
- Sisteme ftohjeje për stabilizimin e produkteve gjatë prodhimit.

Infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë

- Kompania ka siguruar hapësira dhe pajisje për menaxhimin e mbetjeve;
- Nuk ka pajisje për monitorimin e zhurmës dhe emetimeve;
- Ka instaluar sisteme për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat (fikëse zjarri, dalje emergjente, etj.);
- Gjithashtu ka vendosur sinjalistikë dhe masa sigurie për mbrojtjen e punonjësve dhe mjedisit.

Kjo infrastrukturë siguron funksionim të qëndrueshëm të aktivitetit, duke përmbushur kërkesat teknike dhe mjedisore, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.

2.10. Aktivitetet shitesë për zbatimin e projektit

Nuk parashihet ndërtimi i objekteve tjera dhe zhvillim i aktiviteteve shitesë. Aktiviteti realizohet në infrastrukturën ekzistuese.

2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme

Për ndërtimin, funksionimin dhe operimin e impiantit të “Sem-Pro” NTP, kompania është e detyruar të sigurojë të gjitha lejet dhe licencat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Këto përfshijnë:

1. Objekti ka leje ndërtimore – për ndërtimin të lëshuar nga autoriteti kompetent komunal;
2. Duhet të pajiset me pëlqim mjedisor – i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH), pas hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).
3. Leje mjedisore – E nevojshme për operimin e impiantit, përfshirë monitorimin dhe menaxhimin e mbeturinave, ujërave, emisioneve të pluhurit dhe zhurmës.
4. Leje ujore (nëse aplikohet) – për përdorimin dhe shkarkimin e ujërave, në përputhje me legjislacionin për ujërat;

2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera

Projekti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC të kompanisë “Sem-Pro” NTP zhvillohet brenda një konteksti më të gjerë të zhvillimit industrial dhe mjedisor në zonën e Dushanovës, Komuna e Prizrenit. Ai nuk funksionon në mënyrë të izoluar, por lidhet ngushtë me projekte të tjera të riciklimit, menaxhimit të mbetjeve dhe zhvillimit infrastrukturual në nivel lokal dhe rajonal. Në aspektin e menaxhimit të mbetjeve, projekti kontribuon në sistemin ekzistues të riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke krijuar mundësi për bashkëpunim me operatorë të tjerë që trajtojnë materiale të ngjashme. Kjo lidhje nuk rrit vetëm efikasitetin e përpunimit, por gjithashtu lejon shkëmbim teknologjik dhe përmirësim të praktikave industriale në rajon.

Projekti lidhet gjithashtu me infrastrukturën ekzistuese, duke përfituar nga rrjeti elektrik dhe rrugët lokale për furnizim dhe transport. Përmes këtij integrimi, aktiviteti shfrytëzon në mënyrë optimale burimet ekzistuese dhe kontribuon në planet e zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë dhe mobilitetit në komunë.

Nga ana mjedisore, projekti përputhet me strategjitë dhe programet lokale për reduktimin e ndotjes dhe promovimin e riciklimit, duke e bërë pjesë të një sistemi më të madh të qëndrueshmërisë. Materiali i ricikluar që prodhohet mund të përdoret edhe në projekte të tjera prodhuese që

shfrytëzojnë plastikë të ricikluar, duke krijuar zinxhirë furnizimi më efikas dhe duke zvogëluar mbetjet në nivel rajonal.

Në këtë mënyrë, projekti i “Sem-Pro” NTP krijon një sinergji të qartë me aktivitetet e tjera industriale, mjedisore dhe infrastrukturore. Ai jo vetëm që kontribuon në ekonominë qarkore dhe në menaxhimin më efikas të mbetjeve, por edhe përforcon qëndrueshmërinë dhe koordinimin ndërmjet projekteve të ndryshme në komunën e Prizrenit dhe rrethinat e saj.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti

Projekti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhim i profileve të plastikës të kompanisë “Sem-Pro” NTP zhvillohet në lokacionin e njohur si “Barutni–Magacin – Puta”, i cili ndodhet në ngastrën nr. P-71813023-00035-10, në zona kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit

Aktiviteti i kompanisë “Sem-Pro” NTP zhvillohet në ngastrën nr. P-71813023-00035-10, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit. Lokacioni është përzgjedhur duke marrë parasysh infrastrukturën ekzistuese, qasjen e favorshme për transport dhe manipulim të materialeve, si dhe hapësirat e përshtatshme për operimin e linjave të riciklimit dhe prodhimit.

Objekti ku zhvillohet aktiviteti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimit të profileve plastike posedon leje ndërtimi dhe ka një sipërfaqe bruto prej 2051.46 m², duke përmbushur kërkesat teknike për zhvillimin e aktivitetit industrial.

Lokacioni është i vendosur në anën e majtë të rrugës tranzitore Dushanovë – Lubizhdë, në kilometrin e parë të kësaj rruge. Pozita gjeografike konsiderohet e favorshme, pasi ofron lidhje të mirë me rrjetin rrugor lokal dhe rajonal. Përmes rrugëve lidhëse dhe tranzitit të ri, lokacioni ka qasje në: magjistralen Prizren – Suharekë; magjistralen Prizren – Gjakovë; si dhe në autostradën “Ibrahim Rugova”, e cila ndodhet në afërsi.

Kjo lidhje infrastrukturore mundëson qarkullim efikas të lëndës së parë dhe produkteve të gatshme, pa krijuar ngarkesë të konsiderueshme për zonat përreth.

Nga aspekti hapësinor dhe urbanistik, lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit, pasi nuk ndodhet në afërsi të drejtpërdrejtë të zonave të banuara, duke minimizuar ndikimet e

mundshme për komunitetin lokal. Orientimi i objekteve dhe organizimi i hapësirës mundësojnë funksionim optimal të procesit teknologjik.

Në afërsi të lokacionit janë të pranishme edhe aktivitete të tjera industriale dhe ekonomike, si: baza për prodhimin e betonit, depo të materialeve ndërtimore, pika të furnizimit me derivate, si dhe objekte tregtare dhe shërbyese. Prania e këtyre aktiviteteve e karakterizon zonën si zonë me zhvillim industrial dhe komercial, duke e bërë atë të përshtatshme për realizimin e projektit në fjalë.

Pamjet satelitore dhe fotografitë e terrenit, të bashkëngjitura në këtë raport, paraqesin qartë pozicionin e lokacionit dhe kontekstin përreth tij.




Fig. 2. Pamja satelitore e lokacionit.

Më poshtë janë të bashkangjitura fotografi nga tereni dhe parcela se ku është bërë planifikimi i realizimit të këtij projekti.

Foto nga lokacioni:





3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth

Lokacioni ku është duke operuar kompania “Sem-Pro” NTP, është e larguar mbi 800 metra nga objektet banuese më të afërta, kështu që në pikëpamje mjedisore, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit ku do të realizohet projekti, nuk do të kenë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen në këtë veprimtari është i lartë. Banorët e fshatrave për rreth lokacionit kryesisht merren me bujqësi, pemëtari, blegtori dhe aktivitete të minerare. Në afërsi të lokacionit ekzistojnë objekte dhe aktivitete industriale të ngjashme, si fabrika të tjera, baza për prodhimin e betonit, të cilat janë të dukshme në pamjet satelitore dhe fotografite të terrenit të bashkëngjitura më poshtë.




Fig. 4. Distanca nga shtëpitë e banimit

3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike

Zona e Dushanovës bën pjesë në Rrafshin e Prizrenit dhe karakterizohet nga toka bujqësore me pjellori mesatare deri të mirë. Nga aspekti pedologjik, toka në zonën e projektit përbëhet kryesisht nga toka të tipit aluvial dhe deluvial, me përbërje mesatare teksturore (argjilo-ranore). Në disa pjesë, për shkak të zhvillimit industrial dhe ndërhyrjeve antropogjene, shtresa sipërfaqësore e tokës është e modifikuar. Zona nuk shquhet për toka me vlera të larta bujqësore, dhe përdorimi aktual është kryesisht për aktivitete industriale dhe ekonomike. Gjeomorfologjikisht, Relievi i zonës është kryesisht fushor me pjerrësi të vogël, i cili mundëson ndërtim dhe zhvillim të lehtë të infrastrukturës industriale. Terreni është relativisht i qëndrueshëm dhe nuk paraqet rrezik të theksuar nga rrëshqitjet e tokës apo erozioni aktiv. Nga pikëpamja gjeologjike, Nga aspekti gjeologjik, zona përbëhet nga depozitime sedimentare të formuara gjatë periudhave gjeologjike të fundit, kryesisht zhavorr, rërë dhe argjilë. Këto formacione ofrojnë kushte të përshtatshme për ndërtim dhe për vendosjen e objekteve industriale, me kapacitet të mirë mbajtës të tokës. Nuk janë evidentuar struktura gjeologjike të paqëndrueshme në lokacionin e projektit. Hidrogjeologjikisht,

Zona karakterizohet nga prania e ujërave nëntokësore në thellësi të ndryshme, varësisht nga struktura e tokës dhe kushtet lokale. Nuk janë identifikuar burime të rëndësishme ujore në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit që mund të ndikohen ndjeshëm nga aktiviteti. Megjithatë, për të parandaluar ndotjen e mundshme, është e nevojshme zbatimi i masave mbrojtëse për menaxhimin e ujërave dhe mbetjeve gjatë operimit. Në aspektin sizmologjik, rajoni konsiderohet me aktivitet sizmik mesatar, i lidhur me strukturat tektonike rajonale, prandaj projektimi i objekteve duhet të jetë në përputhje me standardet e ndërtimit antisizmik. Në tërësi, këto karakteristika natyrore përcaktojnë kushtet bazë mjedisore dhe inxhinierike për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe industriale në këtë zonë.

3.5. Burimi i furnizimit me ujë

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Bistrica, Toplluga dhe Drini i Bardhë, por në bazë të shpimeve të puseve që janë bërë nga komuniteti për nevoja personale dhe informatave të marrura nga ta, thellësitë e ujërave nëntokësore janë mesatare. Ujërat e lumit Bistrica e Prizrenit, Toplluga dhe të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij. Furnizimi me ujë për nevojat e kompanisë “Sem-Pro” NTP me aktivitet të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhim i profileve të plastikës merret nga pusët personale të cilat janë në oborrin e kompanisë dhe janë të lidhur me rrejtin.

3.6. Karakteristikat klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç’arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasi të bores me ç’rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat

më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej - 0.5°C.

Regjimi i reshjeve në komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri në 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226% dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27%, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna)

Zona rurale përreth fshatrave Dushanovë, Landovicë, Piranë, Lubizhdë dhe Arbanas në territorin e Komunës së Prizren, karakterizohet nga një mbulesë bimore tipike e Rrafshit të Dukagjinit me ndikime sub-mesdhetare. Vegjetacioni në hapësirën ku planifikohet aktiviteti industrial është kryesisht i tipit barishtor dhe shkuror sekondar, i zhvilluar mbi toka të degraduara dhe pjesërisht ranore. Hasen barëra shumëvjeçare spontane, manaferra, murrizi, si dhe kaçuba të qarrit, bungut dhe akacies, të përshtatura për substrat argjilor dhe kushte relativisht të thata.

Fauna përfaqëson një komunitet tipik të zonave agro-pyjore të ultësirës së Dukagjinit. Sipas vëzhgimeve të përgjithshme dhe të dhënave lokale, në këtë hapësirë gjenden gjitarë të zakonshëm si lepuri i egër, dhelpira, ujku, derri i egër dhe iriqi, ndërsa nga brejtësit paraqiten lloje të ndryshme minjsh fushorë. Reptilët përfaqësohen nga gjarpri i zakonshëm, bolla, breshka tokësore dhe hardhuca e gjelbër. Entomofauna është e pasur me insekte të zakonshme të rendit Coleoptera dhe Lepidoptera, si dhe dipterë të ndryshëm. Avifauna përfshin shpendë tipikë të habitateve të hapura dhe bujqësore, si thëllëza e fushës, bilbili, sorrat, çafkat dhe grabitqarë të rastësishëm si shqiponja, si dhe lakuriqet e natës. Në përgjithësi, biodiversiteti i zonës është i zakonshëm për habitatet rurale dhe nuk përfaqëson ekosisteme të ndjeshme apo specie të rralla me rëndësi të veçantë konservuese.

3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale

Karakteristikat e peizazhit në zonën e analizuar, përkatësisht në hapësirën e fshatrave Dushanovë, Landovicë, Piranë, Arbanas dhe Lubizhdë në territorin e Komunës së Prizren, përbëjnë një element të rëndësishëm në vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet aktivitetit industrial të planifikuar dhe mjedisit përreth. Peizazhi paraqet një kategori perceptuese me dimension psikologjik dhe afektiv, e cila formësohet nga bashkëveprimi sinergjik i elementeve natyrore (relievi fushor, toka bujqësore, vegjetacioni i ulët) dhe elementeve antropogjene (objekte bujqësore, infrastruktura rrugore dhe aktivitete të tjera industriale ekzistuese).

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Andaj pritet nga kompania që të punoj në harmoni me natyrën dhe të mos ndikoj në aspekt negative në pamjen vizuale të zonës ku zhvillohet aktiviteti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhim i profileve të plastikës.

3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike

Sipas të dhënave zyrtare të institucioneve përkatëse, në lokacionin e impinatit të kompanisë “Sem-Pro” NTP dhe në afërsi të saj nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ose historike, as zona me potencial arkeologjik. Ndërsa në distancë më të largët ose nese flasim për komunën e Prizrenit si zona të veçanta të mbrojtura kemi: Malet e Sharrit, Kalaja e Prizrenit, Ura e Gurit dhe objekte tjera të kultit religjioz.

3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike

Një nga elementet kryesore për vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të projektit është shpërndarja dhe dendësia e popullsisë në hapësirën përreth lokacionit. Territori i Komunës së Prizren përfshin rreth 640 km² (afërsisht 5.94 % të territorit të Kosovës) dhe përbëhet nga 76 vendbanime me rreth 220,776 banorë, prej të cilëve rreth 110,000 jetojnë në qytetin e Prizrenit. Vendbanimet më të afërta me zonën e projektit karakterizohen nga tipologji rurale, me shtëpi të shpërndara dhe densitet relativisht të ulët banimi, çka zvogëlon potencialin e ekspozimit të drejtpërdrejtë të popullsisë ndaj ndikimeve të mundshme nga aktiviteti industrial.

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të zonës krijojnë parakushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe aktiviteteve rekreative. Rajoni ndodhet përgjatë një korridori të rëndësishëm natyror që historikisht ka lidhur pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik me bregdetin Adriatik, faktor që ka ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe urbanistik të zonës. Kushtet hidrologjike dhe klimatike favorizojnë veçanërisht prodhimin bujqësor, ndërsa resurset natyrore dhe kulturore mbështesin zhvillimin e turizmit rural. Si rezultat, struktura ekonomike e komunës dominohet nga aktivitetet bujqësore dhe turistike, të cilat përbëjnë bazën e zhvillimit socio-ekonomik të popullsisë lokale dhe duhet të merren parasysh gjatë planifikimit dhe operimit

të projektit për të shmangur ndërhyrje të panevojshme në cilësinë e jetës dhe aktivitetet ekzistuese ekonomike.

3.11. Objektet ekzistuese

Në zonë janë të pranishme objekte industriale (Fabrika të prodhimit dhe përpunimit, Pompa të derivateve, depo, markete, restorante, fabrika për prodhimin e Betonit, etj). Aktiviteti i propozuar përfaqëson vazhdimësi të funksioneve ekzistuese dhe nuk krijon konflikt me shfrytëzimin aktual të hapësirës, nese flasim për gjendejen ekzistuese.

3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta

Zona ku planifikohet zhvillimi i aktivitetit të lartëcekur ndodhet në një hapësirë kryesisht rurale dhe industriale, me tokë bujqësore dhe sipërfaqe të degraduara me objekt të ndërtuar sipas lejës ndërtimore të lëshuar nga komuna e Prizrenit. Bazuar në të dhënat aktuale dhe shqyrtimet vizuale, nuk janë identifikuar zona të mbrojtura natyrore, parqe kombëtare apo rezervate ekologjike në afërsi të lokacionit, ndërsa nuk rezultojnë as pasuri të dokumentuara arkeologjike ose monumente të kulturës së njohur.

Përsa i përket kërkimeve shkencore, nuk ka studime të thelluara ekologjike ose biologjike që të përqendrohen specifiku në florën dhe faunën e këtij lokacioni, përveç vërtetimeve paraprake që tregojnë praninë e bimëve barishtore, shkurreve si kaçuba e qarrit, manaferra, akacia, dhe disa specieve të kafshëve si gjitarë, zvarranikë dhe insekte. Kjo tregon se zona nuk përfshin ekosisteme të ndjeshme ose të rralla, por ka karakter të ekosistemit të zakonshëm rural dhe të degraduar ilegalisht.

Nga ana e zonave me qëllime të veçanta, nuk identifikohen hapësira me destinim turistik, rekreativ, kulturor apo edukativ që mund të ndikohen direkt nga zhvillimi i projektit. Megjithatë, afërsia me vendbanimet rurale dhe rrugët lokale kërkon që aktiviteti të menaxhohet me kujdes, duke minimizuar zhurmën, pluhurin dhe ndotjen vizuale për të mos ndërhyrë negativisht në përdorimin aktual të territorit dhe për të respektuar nevojat e komunitetit lokal.

4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT

Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor në territorin e analizuar në zonën kadastrale Dushanove të Komunës së Prizrenit karakterizohet nga presione mjedisore të moderuara, kryesisht për shkak të aktivitetit bujqësor, përdorimit të tokës për kulturat sezonale dhe pranisë së aktiviteteve industriale,

përfshirë markete, pompa të dreivateve, depo të materialit ndërtimor, bazat e betonit. Përveç ndikimeve të natyrës njerëzore, këto zona kanë një ekosistem rural të karakterizuar nga bimësi barishtore, shkurre dhe hapësira me rërë, ndërsa fauna përfshin gjitarë të vegjël, zvarranikë, insekte dhe zogj lokalë.

4.1. Degradimi i mjedisit: Problemet kryesore të identifikuara lidhen kryesisht me ndotjen e ajrit nga aktiviteti i riciklimit dhe prodhimit. Nuk janë raportuar burime të rënda industriale apo ndotës të mëdhenj të ajrit, por aktivitetet e lartëcekura mund të ndikojnë si të lokalizuar në cilësinë e ajrit dhe në peizazhin vizual.

4.2. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në zonën ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë "Sem-Pro" NTP, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, ndikohet nga faktorë natyrorë dhe antropogjenë, duke reflektuar karakterin e përzier industrial dhe peri-urban të kësaj zone.

Burimet kryesore që ndikojnë në cilësinë e ajrit në këtë zonë përfshijnë:

- Qarkullimi i automjeteve në rrugët lokale dhe magjistrale përreth;
- Aktivitetet industriale ekzistuese në afërsi (p.sh. baza betoni, depo materiale ndërtimore);
- Pluhuri i gjeneruar nga sipërfaqet e pa asfaltuara dhe aktivitetet ndërtimore;
- Kushtet klimatike dhe meteorologjike (era, temperatura, reshjet), të cilat ndikojnë në shpërndarjen e ndotësve.

Aktualisht, zona nuk konsiderohet si një pikë me ndotje të lartë të ajrit në nivel rajonal, megjithatë, në periudha të caktuara mund të ketë rritje të përkohshme të përqendrimeve të pluhurit (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), veçanërisht gjatë aktiviteteve intensive industriale ose në kushte të thata atmosferike.

Nga aspekti i aktivitetit të projektit, burimet potenciale të ndotjes së ajrit lidhen me:

- Procesin e përpunimit mekanik të materialit (pluhur);
- Procesin e ekstruzimit (emetime të lehta të gazeve dhe avujve);
- Lëvizjen e automjeteve transportuese brenda dhe jashtë lokacionit.

Megjithatë, duke qenë se objekti është i pajisur me sisteme ventilimi dhe filtrimi, dhe duke zbatuar masa të kontrollit të pluhurit dhe emetimeve, pritet që ndikimi në cilësinë e ajrit të jetë i kufizuar dhe brenda standardeve të lejuara.

4.2. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Zona ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë “Sem-Pro” NTP, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, karakterizohet nga mungesa e burimeve të mëdha ujore sipërfaqësore në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit. Ujërat sipërfaqësore në këtë zonë përfaqësohen kryesisht nga rrjedha të vogla sezonale dhe kanale kulluese, të cilat nuk kanë ndjeshmëri të lartë ekologjike.

Në aspektin hidrogjeologjik, zona përmban ujëra nëntokësore në thellësi të ndryshme, të cilat janë të lidhura me përbërjen gjeologjike të terrenit (depozitime aluviale dhe sedimentare). Këto ujëra mund të shfrytëzohen në mënyrë të kufizuar për qëllime teknike ose bujqësore, por nuk paraqesin burime të rëndësishme strategjike në afërsi të menjëhershme të lokacionit.

Burimet potenciale të ndikimit në ujëra në kuadër të aktivitetit përfshijnë:

- Ujërat e përdorura gjatë proceseve të pastrimit dhe ftohjes;
- Rrjedhjet e mundshme të materialeve ose substancave gjatë manipulimit dhe magazinimit;
- Ujërat atmosferike që mund të bien në kontakt me sipërfaqe të ndotura brenda lokacionit.

Megjithatë, duke qenë se aktiviteti zhvillohet në një objekt të ndërtuar dhe të organizuar, dhe duke pasur sisteme të kontrolluara për menaxhimin e ujërave, ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore pritet të jetë minimal.

4.3. Toka dhe përdorimi i saj

Zona ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë “Sem-Pro” NTP, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, karakterizohet nga përdorim i përzier i tokës, me dominim të aktivitetëve industriale dhe ekonomike. Në afërsi të lokacionit janë të pranishme depo materiale ndërtimore, baza prodhuese dhe aktivitete të tjera tregtare, çka e bën zonën të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetëve industriale.

Nga aspekti pedologjik, toka në këtë zonë është e tipit aluvial dhe deluvial, me përbërje mesatare dhe me kapacitet të mirë mbajtës. Megjithatë, për shkak të zhvillimit të aktivitetit industrial dhe ndërhyrjeve të mëparshme, një pjesë e sipërfaqes së tokës është e modifikuar dhe e shfrytëzuar për ndërtim dhe operim të objekteve afariste.

Lokacioni i projektit është i sistemuar dhe i shtruar pjesërisht, duke reduktuar kontaktin direkt të proceseve industriale me tokën natyrore. Kjo kontribuon në uljen e rrezikut për ndotje të tokës nga aktiviteti i zhvilluar.

Burimet potenciale të ndikimit në tokë përfshijnë:

- Rrjedhjet e mundshme të materialeve plastike ose substancave ndihmëse gjatë manipulimit dhe magazinimit;

- Depozitimi i papërshtatshëm i mbetjeve;
- Aktivitetet e transportit dhe qarkullimit të mjeteve brenda lokacionit.

Megjithatë, duke qenë se aktiviteti zhvillohet në një hapësirë të kontrolluar dhe të organizuar, dhe duke zbatuar masa të duhura për menaxhimin e mbetjeve dhe materialeve, ndikimi në tokë pritet të jetë i kufizuar.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Në kuadër të hartimit të këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, janë shqyrtuar alternativa të ndryshme për realizimin e projektit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimit të dërrasave dhe profileve plastike nga kompania “Sem-Pro” NTP. Analiza e alternativave ka për qëllim identifikimin e zgjidhjes më të përshtatshme nga aspekti teknik, ekonomik dhe mjedisor.

Një nga alternativat kryesore të shqyrtuara është **alternativa e mosrealizimit të projektit (alternativa “zero”)**, e cila nënkupton moszhvillimin e aktivitetit të riciklimit në këtë lokacion. Kjo alternativë do të kishte si pasojë mungesën e përfitimeve ekonomike dhe mjedisore që sjell riciklimi i mbetjeve të plastikës, si dhe vazhdimin e deponimit të tyre në mënyrë të pakontrolluar ose më pak efikase.

Një alternativë tjetër e analizuar është **zgjedhja e lokacionit alternativ**. Megjithatë, duke qenë se objekti ekzistues është tashmë i ndërtuar, i pajisur me infrastrukturën e nevojshme dhe i integruar në një zonë me karakter industrial, zhvendosja e aktivitetit në një lokacion tjetër do të kërkonte investime të konsiderueshme dhe mund të sillte ndikime të reja mjedisore. Për këtë arsye, lokacioni aktual konsiderohet më i përshtatshmi.

Është shqyrtuar gjithashtu **alternativa teknologjike**, që lidhet me përdorimin e teknologjive të ndryshme për përpunimin e PVC-së. Teknologjia e përzgjedhur për projektin bazohet në procese mekanike dhe termike të kontrolluara (grimcim dhe ekstruzim), të cilat konsiderohen efikase, ekonomikisht të përballueshme dhe me ndikim relativisht të ulët në mjedis kur krahasohen me teknologjitë më të vjetra ose më pak të kontrolluara.

Një alternativë tjetër ka të bëjë me **kapacitetin e prodhimit**, ku është vlerësuar mundësia e rritjes ose zvogëlimit të kapacitetit të përpunimit. Kapaciteti aktual është përcaktuar në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me kërkesat e tregut dhe kapacitetin mbajtës të mjedisit, duke shmangur mbingarkesën e burimeve dhe infrastrukturës.

Në përfundim, analiza e alternativave tregon se zhvillimi i aktivitetit në lokacionin ekzistues, me teknologjinë e përzgjedhur dhe kapacitetin aktual, përfaqëson zgjidhjen më të favorshme nga aspekti teknik, ekonomik dhe mjedisor. Ky opsion siguron balancë ndërmjet zhvillimit industrial dhe mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

5.2. Arsye kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar

Arsyeja kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar për projektin e riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC nga kompania “Sem-Pro” NTP bazohet në kombinimin e faktorëve mjedisorë, teknikë dhe ekonomik, të cilët sigurojnë funksionim të qëndrueshëm dhe minimizim të ndikimeve negative në mjedis:

1. Përshtatshmëria e lokacionit

- Lokacioni dhe objekti i ndërtuar ka sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e linjave teknologjike dhe magazinave të mbetjeve PVC.
- Distanca mbi 800 metra nga objektet banuese minimizon ndikimet negative të zhurmës, pluhurit dhe emetimeve për komunitetin lokal.
- Qasja e favorshme në rrugë lokale dhe rajonale siguron transport efikas të lëndës së parë dhe produkteve të ricikluara.

2. Infrastruktura ekzistuese dhe e përshtatur

- Objekti është i përfunduar dhe funksional, me hapësira të dedikuara për magazinim, përpunim dhe riciklim të mbetjeve PVC.
- Ekzistojnë sisteme për ventilim, filtrim, ftohje dhe menaxhim të ujërave të zeza, që lehtësojnë respektimin e standardeve mjedisore.

3. Minimizimi i ndikimeve mjedisore

- Alternativa e zgjedhur siguron menaxhim të kontrolluar të mbetjeve të riciklueshme dhe të rrezikshme.

- Monitorimi i zhurmës, pluhurit dhe emetimeve realizohet në mënyrë sistematike, duke e mbajtur ndikimin brenda kufijve ligjorë.
- Integrimi i masave parandaluese, zbutëse dhe kontrolluese garanton përputhshmëri me ligjet dhe udhëzimet administrative për VNM.

4. Efikasiteti operacional dhe ekonomik

- Proceset e përpunimit mekanik dhe ekstruzimit janë optimizuar për të maksimizuar ripërdorimin e PVC-së dhe minimizuar humbjet.
- Alternativa e zgjedhur lejon përdorim efikas të energjisë, ujit dhe burimeve njerëzore, duke siguruar operim të qëndrueshëm dhe të ekonomshëm.

5. Përputhja me legjislacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm

- Zgjedhja e këtij lokacioni dhe modelit operacional garanton përputhshmëri me ligjin për VNM, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe udhëzimet administrative relevante.
- Aktiviteti integron praktikën e riciklimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke krijuar sinergji me projekte të tjera rajonale dhe duke kontribuar në ekonominë qarkore.

5.3. Vendndodhja ose rruga

Projekti i riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimit të profileve plastike nga kompania “Sem-Pro” NTP zhvillohet në lokacionin “Barutni–Magacin – Puta”, në ngastrën nr. P-71813023-00035-10, në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

Karakteristikat kryesore të vendndodhjes dhe rrugës:

1. Pozita gjeografike:

- Lokacioni ndodhet në anën e majtë të rrugës tranzitore Dushanovë – Lubizhdë, në kilometrin e parë të kësaj rruge.
- Distanca mbi 800 metra nga objektet banuese më të afërta, duke minimizuar ndikimin në komunitet.

2. Qasja në rrjetin rrugor:

- Përmes rrugëve lidhëse, lokacioni ka qasje të drejtpërdrejtë në:
 - Magjistralen Prizren – Suharekë

- Magjistralen Prizren – Gjakovë
- Autostradën “Ibrahim Rugova”, e cila ndodhet në afërsi.
- Kjo lidhje lejon transport efikas të lëndës së parë dhe produkteve të ricikluara pa shkaktuar ngarkesë të konsiderueshme për zonën përreth.

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për kompaninë “**Sem-Pro**” NTP, aktiviteti i propozuar mund të ndikojë në mjedis dhe shëndetin e njeriut në disa mënyra, por me masat e planifikuara, ndikimet mbeten të kontrolluara dhe të pranueshme.

1. Ndikimet në ajër

- **Burimet e ndotjes:** pluhuri nga thyerja dhe grimcimi i PVC-së; avuj dhe gazra të lehta gjatë ekstruzionit dhe ngrohjes.
- **Efektet:** ekspozim i punonjësve ndaj pluhurit dhe gazrave; ndotje lokale e ajrit.
- **Masat parandaluese:**
 - Sisteme ventilimi dhe filtrimi për reduktimin e pluhurit dhe gazrave.
 - Monitorim i rregullt i cilësisë së ajrit.
 - Trajnime për punonjësit mbi përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

2. Ndikimet në uje

- **Burimet e ndotjes:** ujërat e ndotura nga pastrimi i materialit dhe ftohja e pajisjeve.
- **Efektet:** potencial i kontaminimit të ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore nëse nuk trajtohet si duhet.
- **Masat parandaluese:**
 - Sisteme trajtimi të ujërave të zeza (sedimentim, filtrim, trajtime shitesë).
 - Shkarkimi i ujërave vetëm pas kontrollit të parametrave sipas standardeve ligjore.

3. Ndikimet në tokë

- **Burimet e ndotjes:** depozitimi i mbetjeve jo të riciklueshme, mbetje të rrezikshme (vajra teknike, filtra).
- **Efektet:** kontaminim lokal i tokës nëse nuk menaxhohet.
- **Masat parandaluese:**
 - Depozitim i kontrolluar dhe i etiketuar i mbetjeve të rrezikshme.
 - Dorëzim te operatorë të licencuar për trajtim dhe asgjësim.
 - Monitorim dhe pastrim periodik i zonës.

4. Ndikimet akustike

- **Burimet e zhurmës:** makineritë e përpunimit dhe linjat e ekstruzionit.
- **Efektet:** ekspozim i punonjësve ndaj zhurmës; shqetësim i komunitetit lokal.
- **Masat parandaluese:**
 - Vendosja e pajisjeve në ambiente të mbyllura.
 - Mirëmbajtja e rregullt e makinerive.
 - Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse për dëgjimin e punonjësve.

5. Ndikimet në biodiversitet dhe peizazh

- Lokacioni ndodhet kryesisht në tokë industriale dhe degraduar; nuk ka ekosisteme të ndjeshme apo specie të rrezikuara.
- Peizazhi nuk ndryshohet ndjeshëm, pasi aktiviteti zhvillohet në infrastrukturën ekzistuese.
- Masat për të minimizuar efektet vizuale: organizimi i hapësirës dhe mirëmbajtja e ambientit të lokacionit.

6. Ndikimet në shëndetin e njeriut

- Për punonjësit: ekspozim ndaj pluhurit, gazrave të lehta, zhurmës dhe kimikateve të vogla.
- Për komunitetin: ndikim minimal, për shkak të distancës mbi 800 m nga zonat e banuara dhe sistemit të kontrollit të emetimeve.
- Masat parandaluese për shëndetin e njeriut:
 - Trajnime të detyrueshme dhe periodike për masat mjedisore dhe sigurinë industriale.
 - Përdorim i pajisjeve mbrojtëse personale.
 - Monitorim dhe raportim i vazhdueshëm i parametrave ambientale.

5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit

Procesi fillon me pranimin dhe kontrollin e materialit të ricikluar. Mbetjet e PVC-së vijnë nga furnitorë të autorizuar dhe kontrollohen për llojin e plastikës, ngjyrën dhe nivelin e ndotjes. Materialet që nuk plotësojnë standardet për riciklim veçohen dhe dërgohen për trajtim të veçantë ose për menaxhim të mbetjeve.

Pasi materiali miratohet, ai depozitohet në magazina të përshtatura, të cilat ofrojnë mbrojtje nga lagështia, dielli dhe ndotjet e jashtme. Më pas, materiali i ricikluar selektuar sipas ngjyrës, përbërjes dhe madhësisë, pastrohet nga papastërtitë e dukshme dhe objektet jo të dëshirueshme. Ky hap siguron që produkti final të ketë cilësi të qëndrueshme dhe homogjene.

Hapi i tretë është përpunimi mekanik, i cili përfshin: Thyerjen dhe grimcimin e materialit në madhësi të përshtatshme për procesin e riciklimit; Homogjenizimin e materialit për të siguruar uniformitet në përbërje; Kontrollin e cilësisë së materialit të përpunuar për parametrat e lagështisë, densitetit dhe madhësisë së grimcave.

Hapi i katërt është ekstruzimi dhe formimi i produkteve, ku materialet e përpunuara futen në makineritë e ekstruzimit. Materiali nxehet në temperatura të kontrolluara për shkrirjen e tij, dhe më pas formohet në: Dërrasa plastike me dimensione të caktuara; Profile plastike sipas formave të parapara (profil linear, kanale, bordura, etj.).

Gjatë ekstruzimit monitorohen me kujdes parametrat teknikë: temperatura e shkrirjes, presioni i materialit, shpejtësia e ekstruzionit dhe koha e ftohjes, për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve.

Hapi i pestë përfshin ftohjen, prerjen dhe paketimin: Produktet e formuara kalojnë në tunelet e ftohjes për të stabilizuar strukturën e plastikës; Pasi ftohen, ato prerën sipas dimensioneve të kërkuara për tregun ose klientët industrialë; Në fund, produktet pakohet dhe etiketohen për ruajtje, transport dhe distribuim, duke siguruar mbrojtje nga dëmtimet.

Menaxhimi i mbetjeve dhe kontrolli ambiental është një pjesë integrale e procesit: Mbetjet që nuk mund të përdoren trajtohen sipas procedurave të standardizuara mjedisore; Sistem ventilimi dhe filtrimi zvogëlon emetimin e pluhurit dhe gazrave të mundshëm në ambient; Monitorohet vazhdimisht niveli i zhurmës, emetimet dhe parametrat ambientale sipas kërkesave të MMPH dhe standardeve ISO të mjedisit.

Siguria dhe organizimi i punës: Procedurat e sigurisë industriale dhe masat për mbrojtjen e punonjësve duhet të janë të integruara në çdo fazë; Trajnimet periodike për stafin duhet të mbulojnë procedurat operative, masat mjedisore dhe protokollet e emergjencës; Planet e emergjencës dhe protokollet për incidentet mjedisore duhet të janë të implementuara dhe të testuara rregullisht.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit, nga kompania “Sem-Pro” NTP në zonën kadastrale Dushanove, komuna e Prizrenit, vepron sipas një procesi të organizuar dhe të strukturuar për të garantuar cilësinë e produkteve dhe sigurinë mjedisore. Fillimisht, punohet me planifikimin e detajuar të çdo faze të projektit, ku përcaktohen përgjegjësitë e stafit teknik dhe operativ, si dhe procedurat për sigurinë dhe menaxhimin mjedisor.

Materialet e riciklueshme, kryesisht mbeturina plastike PVC, pranohen nga furnitorë të certifikuar. Ato peshohen, regjistrohen dhe depozitohen në ambiente të përshtatshme. Pastrimi dhe ndarja e plastikës sipas tipit dhe ngjyrës është një hap i domosdoshëm për të siguruar cilësinë e produktit përfundimtar.

Procesi i prodhimit përfshin grimcimin e materialit të pastruar, ndjekur nga ekstruzioni dhe formimi i profileve plastike. Çdo profil i prodhuar kontrollohet për qëndrueshmëri, dimensione dhe ngjyrë sipas standardeve industriale, duke garantuar një produkt të qëndrueshëm dhe të sigurt. Materialet që mbeten gjatë prodhimit riciklohen sërish ose depozitohen në mënyrë të sigurt për të minimizuar ndikimin mjedisor.

Siguria e punonjësve dhe shëndeti në vendin e punës janë gjithmonë prioritet. Stafi trajnohet për përdorimin e makinerive dhe pajisjeve mbrojtëse, ndërkohë që monitorimi i ajrit, zhurmës dhe kushteve të punës bëhet periodikisht. Makineritë dhe pajisjet mirëmbahen rregullisht për të parandaluar defektet dhe për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit.

Në këtë mënyrë, kompania kombinon riciklimin efikas të materialeve plastike me prodhimin e profileve cilësore, duke respektuar standardet mjedisore dhe duke siguruar një proces të organizuar dhe të sigurt për punonjësit dhe mjedisin përreth.

5.7. Plani i lokacionit

Projekti zhvillohet në zonën kadastrale Dushanove, komuna e Prizrenit, në një lokacion të përshtatshëm për aktivitetet e riciklimit të mbeturinave plastike dhe prodhimin e profileve nga plastika. Vendndodhja është zgjedhur duke pasur parasysh qasjen e lehtë në rrugë kryesore për furnizimin dhe shpërndarjen e materialeve, si dhe distancën e sigurt nga zonat e banuara për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe shqetësimet për komunitetin.

Territori i lokacionit është i organizuar në mënyrë funksionale: zona për pranimin dhe magazinimin e materialeve plastike, zona e përpunimit dhe prodhimit të profileve, si dhe hapësira për magazinimin e produktit të përfunduar. Rrugët e brendshme dhe sheshet e manovrimit janë të planifikuara për të lehtësuar lëvizjen e mjeteve transportuese dhe makinerive, duke garantuar rrjedhshmëri dhe siguri gjatë operacioneve ditore.

Gjithashtu, në planin e lokacionit janë parashikuar vendet për sistemet e menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave, si dhe hapësirat për mbrojtjen e punonjësve dhe sigurinë e mjedisit, duke respektuar standardet e përcaktuara për aktivitetet industriale dhe riciklimin e materialeve plastike.

5.8. Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit

Për realizimin e aktivitetit të riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimin e profileve plastike, kompania “Sem-Pro” NTP përdor lloje të ndryshme materialesh, të cilat janë përzgjedhur me kujdes për të siguruar efikasitetin e prodhimit, qëndrueshmërinë e produkteve dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore. Materialet kryesore përfshijnë mbetjet plastike PVC të grumbulluara nga furnitorë të autorizuar, të cilat përpunohen dhe ripërdoren si lëndë e parë sekondare.

Përveç materialit bazë PVC, përdoren edhe materiale ndihmëse për stabilizim dhe ngjyrosje të produkteve, aditivë të përshtatshëm për ekstruzion dhe lubrifikantë që sigurojnë një proces të qëndrueshëm dhe produkt final me cilësi uniforme. Materialet për paketim, si kuti, shiritë mbrojtës dhe etiketa, zgjidhen në mënyrë që të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për produktin gjatë magazinimit dhe transportit, duke minimizuar dëmtimet dhe humbjet.

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Projekti i kompanisë “Sem-Pro” NTP, që operon në zonën kadastrale Dushanove, komuna e Prizrenit, është një projekt i cili aktualisht ndodhet në fazën e funksionimit. Bazuar në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e riciklimit dhe prodhimin të plastikës, nuk parashikohet një afat të caktuar për përfundimin e funksionimit, duke pasur parasysh që aktiviteti është i vazhdueshëm në përputhje me normat ligjore.

Megjithatë, kompania është e angazhuar që të respektojë të gjitha afatet e raportimit, licencimit dhe rinovimit të lejeve operative që kërkohen nga institucionet përkatëse. Afatet për ekzekutimin e fazave të ndryshme operationale, si riciklimi i mbeturinave PVC, përpunimi i tyre dhe prodhimi i profileve plastike, përcaktohen sipas planit vjetor të prodhimit dhe kapacitetit teknik të fabrikës, duke siguruar që proceset të realizohen brenda periudhave të planifikuara dhe pa ndërprerje të punës.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Lokacioni i kompanisë “Sem-Pro” NTP ndodhet në zonën kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit, dhe zë një sipërfaqe totale prej 4000 m² tokë. Objekti afarist P+O dhe P+2 ku zhvillohen aktivitetet e riciklimit të mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimit të profileve plastike ka një sipërfaqe të ndërtuar prej 2051,45 m².

Hapësira e lokacionit është e organizuar në mënyrë funksionale, duke përfshirë zona për: magazinimin e mbetjeve të riciklueshme, përpunimin dhe riciklimin, magazinimin e produkteve

të prodhuara, si dhe zona të veçanta për menaxhimin e mbetjeve dytësore dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Rrugët e brendshme dhe zonat e qarkullimit të mjeteve janë të planifikuara për të mundësuar një rrjedhshmëri të qëndrueshme të procesit prodhues dhe për të garantuar siguri për punonjësit. Dimensionet e objektit dhe organizimi i hapësirave janë të përshtatshme për integrimin e pajisjeve teknologjike dhe për funksionim efikas industrial, të dhënat e detajuara i gjeni edhe tek vendimi për leje ndërtimore.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Aktiviteti i kompanisë "Sem-Pro" NTP, i cili zhvillohet në lokacionin Dushanovë, Komuna e Prizrenit, ka si qëllim kryesor riciklimin e mbeturinave të plastikës PVC dhe prodhimin e profileve dhe dërrasave plastike. Procesi i prodhimit zhvillohet në linja të specializuara teknologjike, ku materiali i mbeturinave të PVC-së përpunohet dhe transformohet në lëndë të parë sekondare, e cila përdoret më pas për prodhimin e profileve të ndryshme plastike.

Vëllimi i prodhimit përcaktohet nga kapaciteti teknik i linjave të ekstruzimit dhe makinerive për thyerje, grimcim dhe përpunim mekanik. Aktiviteti është planifikuar të operojë në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit, duke përpunuar sasi të ndryshme mbeturinash PVC sipas kërkesave të tregut dhe nevojave për materialin e ricikluar.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Gjatë funksionimit të projektit, kompania duhet të marrë masa të qarta për kontrollin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Proceset e riciklimit të PVC-së dhe prodhimin e profileve plastike të zhvillohen në një ambient të mbyllur dhe të pajisur me sisteme për filtrimin e grimcave dhe pluhurit, për të parandaluar shpërndarjen e ndotësve në ajër.

Uji i përdorur në proceset teknologjike duhet të përpunohet përpara derdhjes në mjedis, duke përdorur një sistem trajtimi i cili siguron heqjen e ndotësve fizikë dhe kimikë sipas standardeve mjedisore në fuqi.

Gjithashtu, mbeturinat dhe materialet e mbetura duhet të trajtohen sipas procedurave të përcaktuara, duke minimizuar ndikimin mjedisor dhe duke siguruar riciklimin maksimal të materialeve të PVC-së.

5.13. Trajtimi i mbeturinave

Mbeturinat komunale merren nga kompania e kontraktuar nga Komuna. Ndërsa mbeturinat tjera të cilat nuk janë subject i riciklimit duhet të mbledhen dhe dorëzohen për trajtim nga kompani të licencuara;

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes

Objekti i kompanisë, ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugë ekzistuese, gjë që mundëson lidhje të shpejtë dhe të sigurt për transportin e materialeve të ricikluara dhe produkteve të profilave plastike. Infrastruktura rrugore aktuale ofron një rrugë të qëndrueshme dhe të mirëmbajtur, e cila mundëson qarkullim të vazhdueshëm të automjeteve të transportit të brendshëm dhe të jashtëm pa nevojë për ndërhyrje të mëdha.

5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit

Personeli përgjegjës i autorizuar duhet të monitoron sistematikisht treguesit mjedisor. Raportimi i rezultateve të monitorimit do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, përkatësisht nga ekspertët e kompanisë. Raporti do të përfshijë të dhëna të detajuara mbi të gjithë parametrat e monitoruar, sipas kërkesave të Pëlqimit Mjedisor dhe lejes mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH). Raportet do të dorëzohen në kohë dhe në formë të dokumentuar për të garantuar transparencë dhe përputhshmëri me legjislacionin mjedisor.

5.16. Trajnime

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

5.17. Monitorimi

Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren dhe natyrën e aktivitetit, i cili nuk paraqet presion të lartë mjedisor, monitorimi i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm i treguesve mjedisor konsiderohet i domosdoshëm për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm.

5.18. Planet për situata emergjente

Janë parashikuar procedura për reagim në raste emergjente, përfshirë zjarrin dhe ndaljen e pajisjeve.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Pas përfundimit të aktivitetit, të gjitha pajisjet dhe makineritë duhet të çmontohen dhe të largohen nga lokacioni. Objekti, bazamentet dhe platotë e ndërtuara gjatë operimit të impiantit duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe materialet e tyre të dërgohen në deponimet rajonale të përshtatshme. Struktura përfundimtare e zonës duhet të mbulohet me dheun adekuat, në përputhje me substratin ekzistues të tokës, në mënyrë që të rikthehet ekuilibri natyror i tokës. Rikultivimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga aktiviteti minerar përfshin rivitalizimin e plotë të hapësirës, duke e kthyer atë në funksionin e saj primar ose në përputhje me destinacionin e ri të tokës, sipas planeve komunale dhe kërkesave të përdorimit të tokës.

